



NJOFTIM

për zbatimin e trajnimit dhe provimit profesional për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe provimit profesional për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit në sigurime

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve e informon publikun se do të organizojë trajnim dhe provim profesional për ushtrimin e veprimtarive të ndërmjetësimit në sigurime (në tekstin në vijim: trajnim dhe provim profesional për ndërmjetësues) dhe trajnim dhe provim profesional për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit në sigurime (në tekstin në vijim: trajnim dhe provim profesional për broker).

Trajnimi për ndërmjetësues, në kohëzgjatje prej 3 ditësh (gjithsej 18 orë mësimore), do të zbatohet në periudhën kohore 23-26.3.2016, ndërsa trajnimi për broker, në kohëzgjatje prej 4 ditësh (gjithsej 27 orë mësimore), do të zbatohet në periudhën kohore 24-26.3.2016 dhe 2.4.2016. Terminet e sakta dhe orari i detajuar i ligjëratave, në kuadër të trajnimeve, do të publikohen në internet faqen e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve para se të fillojnë trajnimet.

Pas përfundimit të trajnimit, Agjencia do të zbatojë provim profesional për ndërmjetësues, përkatësisht provim profesional për broker. Datat e mbajtjes së provimit profesional për ndërmjetësues, përkatësisht provimit profesional për broker janë:

Pjesa e parë (pjesa teorike) më datë 19.4.2016.

Pjesa e dytë (shembull praktik) më datë 04.5.2016.

Kandidatët, të cilët me të parën herë nuk do ta japin provimin profesional për ndërmjetësues, përkatësisht provimin profesional për broker, kanë të drejtë që provimit t'i nënshtrohen edhe dy herë në afat prej 6 muajsh nga dita e përfundimit të trajnimit edhe atë në terminet si vijojnë:

Hyrja në provim për herë të dytë

Pjesa e parë (pjesa teorike) më datë 10.5.2016.

Pjesa e dytë (shembull praktik) më datë 25.5.2016.

Hyrja në provim për herë të tretë

Pjesa e parë (pjesa teorike) më datë 01.6.2016.

Pjesa e dytë (shembull praktik) më datë 15.6.2016.

Kandidatët, të cilët do ta japin me sukses provimin për ndërmjetësues, përkatësisht broker, do të pajisen me Certifikatë për provimin e dhënë profesional për ndërmjetësues, përkatësisht Certifikatë për provimin e dhënë profesional për broker.



Kandidatët, të cilët tri herë radhazi nuk e japin provimin profesional për ndërmjetësues, përkatësisht provimin profesional për broker, e humbasin të drejtën e hyrjes së sërishme në provim, të parashikuar me trajnim.

Me trajnimin për ndërmjetësues janë përfshirë 6 (gjashtë) sfera – module edhe atë:

1. Bazat e menaxhimit me rrezikun dhe sigurimin;
2. Legjislacioni nga fusha e sigurimeve;
3. E drejta tregtare dhe detyrimore;
4. Ndërmjetësimi në sigurime dhe kodeksi etik;
5. Sigurimi i jetës; dhe
6. Sigurimi jojetësor.

Me trajnimin për broker janë përfshirë 9 (nëntë) sfera – module edhe atë:

1. Bazat e menaxhimit me rrezikun dhe sigurimin;
2. Legjislacioni nga fusha e sigurimeve;
3. E drejta tregtare dhe detyrimore;
4. Ndërmjetësimi në sigurime dhe kodeksi etik;
5. Sigurimi i jetës;
6. Sigurimi jojetësor;
7. Aspektet financiare të veprimtarisë;
8. Regjistrimi i rreziqeve dhe ndërmjetësimi gjatë realizimit të dëmeve; dhe
9. Risigurimi.

Përmbajtja e detajuar e secilit modul nga trajnimi për ndërmjetësues, përkatësisht trajnimi për broker është përpunuar në Programin mësimor për dhënien e provimit profesional për ndërmjetësues në sigurime, përkatësisht Programin mësimor për dhënien e provimit profesional për broker, të cilin e përcakton Agjencia dhe në të cilin përfshihen kurrikulat, aktet normative dhe literatura. Programi mësimor është publikuar në ueb-faqen e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Mënyra dhe procedura e zbatimit të trajnimit dhe provimit profesional për ndërmjetësues, përkatësisht provimit profesional për broker, është përcaktuar në detaje në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e zbatimit të trajnimit për ushtrimin e veprimtarive të ndërmjetësimit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2015), Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e zbatimit të trajnimit për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2015), Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e zbatimit të provimit profesional, ndërkaq ushtrimin e veprimtarive të ndërmjetësimit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/2014) dhe Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e zbatimit të provimit profesional për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/2014).

Kompensimi për pjesëmarrje në trajnim dhe për dhënien e provimit profesional për ndërmjetësues, përkatësisht broker, është përcaktuar në Tarifën për përmbajtjen



dhe lartësinë e kompensimeve dhe detyrimeve të cilat i arkëton Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe afatet e pagesës (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 147/2009, 149/2009, 154/2009, 20/2012, 130/2013, 1/2015 dhe 22/2016) dhe i njëjti është në lartësi prej **7.000 denarë për ndërmjetësues, përkatësisht 14.000 denarë për broker.**

Për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për ndërmjetësues personi duhet t’i plotësojë kushtet si vijojnë:

1. të ketë kryer më së paku arsimin e mesëm;
2. ta zotërojë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik; dhe
3. të mos ketë ushtruar funksion të personit me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme në shoqëri të sigurimeve ose në person tjetër juridik ndaj të cilit është hapur procedurë e falimentimit.

Për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker personi duhet t’i plotësojë kushtet si vijojnë:

1. të ketë kryer arsim të mesëm katërvjeçar;
2. ta zotërojë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik; dhe
3. të mos ketë ushtruar funksion të personit me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme në shoqëri të sigurimeve ose në person tjetër juridik ndaj të cilit është hapur procedurë e falimentimit.

Të gjithë kandidatët e interesuar, **më së voni deri më datë 9.3.2016**, mund të aplikojnë për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për ndërmjetësues, përkatësisht broker, duke i paraqitur dokumentet si vijojnë (me mandapostë: Aplikim për trajnim/Kërkesë për dhënien e provimit) deri te Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (adresa: rr. “Vasill Gllavinov” nr. 12, TCC Plaza, kati 2, Shkup):

1. Formular i plotësuar – Aplikim për pjesëmarrje në trajnim për ndërmjetësues/Kërkesë për dhënien e provimit profesional për ndërmjetësues, përkatësisht Aplikim për pjesëmarrje në trajnim për broker /Kërkesë për dhënien e provimit profesional për broker (i aksesshëm në internet-faqen e Agjencisë, www.aso.mk, ose në arkivin e Agjencisë);
2. Për plotësimin e kushtit, personi të ketë kryer më së paku arsim të mesëm, përkatësisht të ketë kryer arsim të mesëm katërvjeçar – Certifikatë/Diplomë për arsim të mesëm katërvjeçar të kryer (shkalla IV) ose shkallë më të lartë të arsimit, në origjinal ose të verifikuar në noter;
3. Për plotësimin e kushtit, personi ta zotërojë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik – dëshmi se personi ka mësuar/ka dhënë provimin e gjuhës maqedonase gjatë arsimit të tij, të dukshme në Certifikatën/Diplomën për arsim të mesëm të kryer ose shkallë më të lartë të arsimit (për shtetasit maqedonas);
4. Për plotësimin e kushtit, personi ta zotërojë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik – Vërtetim se personi e zotëron gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, të lëshuar nga institucioni kompetent (për shtetas të huaj);



5. Për plotësimin e kushtit, personi të mos ketë ushtruar funksion të personit me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme në shoqëri të sigurimeve ose në person tjetër juridik ndaj të cilit është hapur procedurë e falimentimit – Deklaratë se personi nuk ka ushtruar funksionin e personit me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme në shoqëri të sigurimeve ose në person tjetër juridik ndaj të cilit është hapur procedurë e falimentimit, e verifikuar tek personi i autorizuar – noteri; dhe
6. Dëshmi për kompensimin e paguar për pjesëmarrje në trajnim dhe për dhënien e provimit profesional për ndërmjetësues në sigurime, përkatësisht për broker.

Dëshmia për kompensimin e paguar duhet t'i përmbajë të dhënat si vijojnë:

QËLLIMI I MANDAPOSTËS:	Pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për ndërmjetësues/Pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional për broker
EMËRTIMI I PRANUESIT:	Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve - Shkup
BANKA E PRANUESIT:	Stopanska Banka SHA - Shkup
LLOGARIA:	200002007041251

Informata më të detajuara për mënyrën dhe procedurën e zbatimit të trajnimit dhe provimit profesional, programin mësimor, terminet e saktë dhe vendin e mbajtjes së trajnimeve dhe provimeve profesionale, mund të gjenden në internet-faqen e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (www.aso.mk) ose në numrin e telefonit: 02 3254-050.

SHËNIM: Aplikimet/kërkesat për pjesëmarrje në trajnim dhe dhënien e provimit profesional, të cilat do të dërgohen pas skadimit të afatit për paraqitjen e të njëjtave, nuk do të merren parasysh.

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE